

Seminar me uniformat blu Drejtorisë së Policisë Rajonale të Qarkut Berat

Në qytetin e Beratit, më datë 18/10/2016, në sallën e mbledhjeve të Drejtorisë së Policisë Rajonale të Qarkut Berat u organizua një seminar në kuadër të ciklit të trajnimeve: “Rritja e kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese, që monitorojnë e mbrojnë mjedisin, në luftën kundër Krimit Mjedisor”.

Ky seminar zhvillohet si pjese e projektit: **“Ulja e krimit mjedisor nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese, në Parkun Kombëtar të Tomorrit”, pjesë e programit Achieve – REC Shqipëri, financuar nga Bashkimi Evropian**”.

Të pranishëm në këtë event ishin rreth 20 efektivë të Uniformave blu të Skraparit, Bogovës, Beratit dhe 3 anëtarë të organizatës: “Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore” Berat, e cila është zbatuese e këtij projekti.

Seminari u drejtua nga Znj. Deçolli, e cila drejton organizatën dhe njohu të pranishmit me objektivat e punës së kësaj organizate si dhe projektin që ajo është duke zbatuar. Znj. Erjola Azizolli – menaxhere e projektit, foli për ndjeshmërinë e këtij projekti në të gjithë Qarkun e Beratit, bashkëpunimin ndërinstitutional, sensibilizimin me intensitet rritës që organizata synon të arrijë edhe në vazhdimësi si dhe për synimet finale e për vazhdimësinë e parandalimit të krimit mjedisor.

Në vijim të aktivitetit, trajnerja Znj Asiola Dyrmishi, u fokusua tek mbrojtja e mjedisit si e drejtë penale evropiane .

Ajo theksoi se Krimi në mjedis është shpesh i lidhur me krimin e organizuar dhe me korrupsionin.

Në legjislacionin e BE-së, Direktiva “Për mbrojtjen e mjedisit përmes legjislacionit penal” shpjegon se çfarë është Krimi Mjedisor e çfarë konsiderohet si i tillë.

Në kodin tonë penal, kapitulli i mjedisit miratuar në vitin 1995, nuk përputhet me kërkesat e kësaj direktive, gjë që e vështirëson edhe punën e organeve kompetente.

Parimi “Ndotësi pagan” vë përpara përgjegjësisë të gjithë ata që ndotin me dashje ose jo, mjedisin, të gjithë ata që dëmtojnë duke përfshirë edhe kostot e kompensimit të personave fizikë apo juridikë të dëmtuar, apo edhe kosto rehabilitimi. Trajtimi i këtyre problemeve që dëmtojnë cilësinë e jetës dhe mjedisin e shqiptarëve është prioritet për organizatën tonë.

Ne jemi duke punuar me sensibilizimin e popullatës së zonave të prekura për ta mbrojtur mjedisin duke denoncuar krimin mjedisor, duke rritur më shumë bashkëpunimin me organet kompetente që kanë si qëllim mbrojtjen e tij. Rritja e kapaciteteve të këtyre agjencive ligjzbatuese duhet të bëhet paralelisht me transpozimin e legjislacionit mjedisor në përgjithësi



BASHKIMI EVROPIAN
DELEGACIONI NË SHQIPËRI

ACHIEVE
Albanian Civil Society for an European Environment

REC
Shqipëri

dhe me atë për mbrojtjen e mjedisit përmes legjislacionit penal në veçanti - citoi juristja Arsiola Azizolli.

Qasja e organizatës sonë është të bashkëpunojmë me qytetarët për të mbajtur mjedisin të pastër e të shëndetshëm dhe për të ndëshkuar këdo që e ndot apo dëmton atë, e këtë qasje ne do të vazhdojmë t'a përcjellim tek qytetarët tanë.





BASHKIMI EVROPIAN
DELEGACIONI NE SHQIPËRI

ACHIEVE
Albanian Civil Society for an European Environment

REC
Shqipëri

